



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 06 korrik 2012
Nr. ref.: RK267/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI30/12

Parashtruesi

Afrim Kalaja

**Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së
Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Z. Afrim Kalaja (më tutje: parashtruesi i kërkesës) nga f. Dabishefc, me banim në Prishtinë, rr. "Jakup Ferri", nr. 29.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011 i 24 janarit 2012, për të cilin në formularin për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë pala nuk ka specifikuar datën e pranimit të tij

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 26 mars 2012 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011, në bazë të cilit parashtruesit të kërkesës i është refuzuar ankesa dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr 1168/10, i datës 6.10.2011 e me të cilin “është konstatuar shitja e patundshmërisë së hipotekuar të hipotekëlënsit z. Murat Plakolli’ kreditorit PRO CREDIT BANK me seli në Prishtinë.

Baza ligjore

4. 4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe neni 54, 55 dhe 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 mars 2012, parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua në Gjykatë me nr KI30/12.
6. Më 27 mars 2012, me vendimin GJR KI30/12 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues, zëvendëskryetarin z. Kadri Kryeziu, ndërsa me vendimin KSH 30/12, Kolegjin shqyrtues në përbërje Robert Carolan, kryesues dhe Altay Suroy, gjyqtar, Prof. rr. Enver Hasani, gjyqtar si anëtarë të Kolegjit shqyrtues.
7. Më 5 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 5 qershor 2012 Gjykata njoftoi edhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës duke kërkuar edhe përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën, por nga kjo gjykatë nuk kishte marrë asnjë koment me shkrim lidhur me këtë lëndë.
9. Më 20 qershor Gjykata Kushtetuese ka pranuar përgjigje nga Gjykata Komunale lidhur me rastin, ku shpjegohet kronologjia e lëndës dhe njëkohësisht bashkëngjiten vendimet gjyqësore të cilat Gjykata Kushtetuese tashmë i kishte në dosjen e lëndës të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 3 korrik 2012, pas raportimit të Gjyqtarit raportues, zëvendëskryetarit z. Kadri Kryeziu Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 13 tetor 2008 ProCredit bank me seli pune në Prishtinë në cilësinë,e Kreditëdhënësit ka lidhur Kontratë Për Kredinë nr A-59246, me z. Afrim Kalaja-pronar

- i NTP "Ideal" me seli pune në Prishtinë rr Drenica" nr 29,në cilësinë e kredimarrësit dhe z Murat Plakolli nga Prishtina me banim në rr."Vëllezërit Fazliu" dhe znj. Hasime Kalaja nga Prishtina, rr "Jakup Ferri" nr 29, në cilësinë e bashkëkredimarrësve në vlerë prej 100.000 (njëqindmijë)euro për një periudhë kohore prej 48 muajve.
12. Neni 8 i kësaj kontrate ka paraparë se me nënshkrimin e kësaj kontrate bashkëkredimarrësit marrin përgjegjësi të plotë në zbatimin e kontratës për kredinë në rast se kredimarrësi nuk përmbushë obligimet kontraktuale ndaj kredidhënësit.
 13. Pjesë përbërëse e kësaj kontrate ishte edhe kontrata për Hipotekën e cila kishte objekt patundshmërinë e përshkruar si në fletën poseduese 4949- Komuna e Prishtinës, pronësi e z, Murat Plakolli e lidhur në mes të z. Murat Plakolli nga Prishtina si Hipotekëlënës, në emër të cilit me autorizim gjyqësor kishte nënshkruar z. Muhamet Plakolli dhe .dhe z. Afrim Kalaja ,pronar i NTP "Ideal"në cilësinë e kredimarrësit ,me të cilën hipotekë sigurohej kredia. kryesore në të cilën
 14. Më 20 maj 2010 pas konstatimit se kredia nuk po paguhej sipas kushteve të parapara me kontratën për kredinë ProCredit Bank në cilësinë e kreditdhënësit në Gjykatën Komunale në Prishtinë paraqet **Propozimin për Ekzekutim në Paluejtshmëri-Hipotekë** e cila ishte objekt i kontratës mbi hipotekën.
 15. Më 17 maj 2011 në Gjykatën Komunale në Prishtinë është mbajtur seanca publike sipas propozimit të kreditorit ProCredit Bank në të cilin ka marrë pjesë z. Kalaja në cilësinë e debitorit ndërsa z. Murat Plakolli dhe znj Hasime Kalaja edhe pse kishin marrë ftesat nuk ishin paraqitur në Gjykatë .Nga kopja e procesverbalit konstatohet se z,Afrim Kalaja kishte deklaruar se ai ka marrë kredinë në shumën e theksuar në kontratë për kredinë por pasi ka rënë në krizë financiare nuk ka mundësi ta paguaj atë,
 16. Po të njëjtën ditë, pra 17 maj 2011 Gjykata Komunale ka nxjerrë konkluzion mbi shitjen dhe ka caktuar shitjen e parë publike me ankand publik në patundshmërinë e debitorit z. Murat Plakollit. Gjykata kishte theksuar se "kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa"
 17. Nga procesverbalet e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të mbajtura me rastin e Ankandeve Publike për shitje, konstatohet se janë mbajtur tri ankande të tilla publike dhe atë me 21.07.2011, më 12.09.2011 dhe përfundimisht me 06 10.2011 ku u mbajt edhe seanca e shitjes së patundshmërisë. Gjykata kushtetuese gjithashtu konstaton se me rastin e mbajtjes së seancës së parë debitori-kredimarrësi z. Afrim Kalaja kishte deklaruar se garantuesi-hipoteklënësi z.Murat Plakolli kishte vdekur dhe për këtë ka deponuar certifikatën e vdekjes duke kërkuar njëkohësisht ndryshimin e objektit të hipotekës por kjo gjë nuk u pranua nga kreditori dhe Gjykata Komunale caktoj një përfaqësues të përkohshëm ligjor –avokat z. Naser Peci të mbrojë interesat e z. Plakolli në këtë proces.
 18. Në dy ankandet e para publike nuk kishte pasur asnjë ofertues për të blerë paluejtshmërinë e hipotekuar kështu që në secilin ankand pasues është ulur vlera e pasurisë së hipotekuar.
 19. Më 06 tetor 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë ka nxjerrë Aktvendimin E.nr.1168/10 me të cilin në pikën I –Konstatohet se i është Shitur kreditorit ProCreditbank si ofertues i vetëm - patundshmëria e hipotekëlënësit z. Murat Plakolli e identifikuar në mbi të drejtat e pronës nr UL-71914059-04949 e cila gjendet në ngastrën kadastrale 1994-0 me kulturë shtëpi oborr" në Prishtinë ZK Kolonia e Re në sipërfaqe prej 224 m² në shumën prej 30.000 (tridhjetëmijë euro). Gjithashtu në pikën II janë urdhëruar

debitorët që paluejtshmërinë t`ia dorëzojnë në posedim Kreditorit në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

20. Kundër këtij Aktvendimi në afat ligjor ankesën Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kanë paraqitur z. Afrim kalaja –debitor në cilësinë e përfaqësuesit të NTP'Ideal" dhe z. Naser Peci Avokat në cilësinë e përfaqësuesit të përkohshëm të bashkëkredimarrësit –tani të ndjerit z. Murat Plakolli.
21. Më 24 janar 2012, Gjykata e qarkut ka nxjerrë Aktvendimin Ac.nr 1496/2011 me të cilin ka refuzuar si të pabazuara ankesat e parashtruesve njëkohësisht ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1168/2010 të datës 06.10 2011.
22. Në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhet se Gjykata e Qarkut nuk ka gjetur fakte të jenë shkelur dispozitat e ligjit për Procedurën përmbarimore si dhe se çmimi përfundimtar i pronës së hipotekuar pas dy shitjeve të pasuksesshme është përcaktuar në kuptim të nenit 203.5 të Ligjit për Procedurës Përmbarimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljet Kushtetuese

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e kontestuar Vendimin, janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 21(parimet e përgjithshme),neni 24(barazia para ligjit)neni 54(mbrojtja gjyqësore e të drejtave) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 8 i Deklaratës Universale për të Drejtat e njeriut

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë,Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe rregulloren e punës së Gjykatës
25. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

26. Gjykata me këtë rast merr parasysh edhe :

Rregullin 36 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

*"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartas e bazuar.*

27. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe shkeljeve të pretenduara të drejtave Kushtetuese Gjykata kushtetuese thekson se:
28. Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e faktit, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe e të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta si në rastin konkret që shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, ku në procedurë përmbarimore ishte kompetencë e Gjykatës Komunale dhe e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që vendosën lidhur me pasurinë e hipotekuar sipas kontratës mbi Hipotekën, dhe se roli i sajë (i GJ. Kushtetuese) është vetëm qe ta sigurojë

pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprime si "gjykate e shkalës së katërt", (shih, *mutatis mutandis*, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65

29. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund tu shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Meztur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005 ose , Tengerakis v. Qipro, nr. 35698/03, vendim i datës 9 nëntor 2006, § 74).
30. Në fakt, përpos pakënaqësisë me rezultatin përfundimtar të procesit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur argumente bindëse të cilat do të përkrahnin pretendimet e tij për shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit, sepse në asnjë rast nuk ka paraqitur prova se është trajtuar i pabarabartë me palën kundërshtare në proces gjyqësor dhe në asnjë mënyrë nuk kishte specifikuar se ku qëndron pabarazia e pretenduar.
31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte qenë pjesë aktive e procesit gjyqësor në procedurë përmbartimore dhe nga shkresat që ka bashkangjitur me kërkesën nuk mund të konstatohet se ka dorëzuar prova që do të justifikonin shkeljen e nenit 54 të Kushtetutës së Kosovës (mbrojtja gjyqësore e të drejtave),
32. Për të deklaruar një Aktgjykim a Aktvendim të një autoriteti publik si jo kushtetues, parashtruesi i kërkesës do të duhej *prima facie* të tregojë se "Vendimi i autoritetit publik, si i tillë, do të jetë tregues i një shkeljeje të kërkesës për gjykim të drejtë, dhe nëse, paarsyeshmëria e atij vendimi është aq e dukshme sa që vendimi mund të konsiderohet si vendim **tej mase arbitrar**" (shih GjEDNj, *Khamidov kundër Rusisë*, nr. 72118/01, aktgjykimi i datës 15 nëntor 2007, § 175.
33. Gjykata Kushtetuese në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut Ac.nr 1496/2011 të datës 24. janar. 2012 nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të drejtave të njeriut sikur që parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar.
34. Në këto rrethana parashtruesi i kërkesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar andaj, Gjykata në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d , gjen se kërkesën duhet ta refuzoj si qartas të pabazuar., dhe rrjedhimisht

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e mbajtur me 3 korrik 2012, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Mr.sc.Kadri Kryeziu

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese




Prof. dr. Enver Hasani